



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 14.9.2021

Lënda: Bisedime përfundimtare të Komisionerit Publik në seancën gjyqësore të datës 14.9.2021, para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, për çështjen që i përket ankimit kundër vendimin nr.183, datë 19.7.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Drejtuar: Kolegjit të Posaçëm të Apelit

Baza ligjore: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Në referencë të nenit 302 dhe 303 të Kodit të Procedurës Civile, pasi u shqyrtuan dhe iu nënshtruan debatit gjyqësor të gjitha shkaqet e ankimit, prapësimet e palëve dhe provat e administruara nga Kolegji, në cilësinë e provës gjatë hetimit gjyqësor, në përfundim, duke iu përmbajtur shkaqeve të ankimit dhe parashtrimeve me shkrim të paraqitura në këtë gjykim, Komisioneri Publik paraqet bisedimet përfundimtare si vijon:

I. Për afatin e paraqitjes së ankimit

Subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet mjetit përkatës procedural, i ka kërkuar këtij trupi gjykues konstatimin e paraqitjes së ankimit nga ana e Komisionerit Publik jashtë afatit të parashikuar nga neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Komisioneri Publik u qëndron argumenteve të paraqitura gjatë debatit gjyqësor të zhvilluar para këtij trupi gjykues, në lidhje me këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit. Duke iu referuar edhe jurisprudencës së deritanishme të Kolegjit¹, rezulton se, bazuar në interpretimin gjyqësor të afatit të ankimit dhe mënyrës së përlllogaritjes së tij, ankimi i Komisionerit Publik është paraqitur brenda afatit ligjor.

¹ Shihni prg. 26.2, vendim (JR) nr. 32/2019 dhe prg. 37, vendim (JR) nr.13/2021, i Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

II. Për kontrollin e kriterit të pasurisë

Duke iu referuar shkaqeve të ankimit, Komisioneri Publik kërkoi hetim të mëtejshëm për dy pasuritë e paluajtshme të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, përkatësisht: (i) apartament me sipërfaqe 102.6 m², me vendndodhje rruga “**** **”, Tiranë dhe (ii) apartament me sipërfaqe 63 m², me vendndodhje rruga “**** **”, Tiranë.

Nisur nga gjendja e akteve të administruara gjatë hetimit të Komisionit, u kërkua nga Komisioneri Publik verifikimi i kushteve të: (i) *konfliktit të mundshëm të interesit*; (ii) *veprimeve në dukje fiktive*; dhe (iii) *burimit të ligjshëm të të ardhurave të deklaruara*.

Hetimi dhe verifikimi i kushteve të *konfliktit të mundshëm të interesit* dhe *veprimeve të mundshme fiktive* u kërkua të kryhej sa kohë nga aktet e administruara nga Komisioni, në të dy rastet, çmimet e kontratave të blerjes së këtyre apartamenteve nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe personat e lidhur me të janë dukshëm nën çmimet e referencës, si dhe në kushtet e mungesës së informacionit në lidhje me individin, që kishte kryer pagesën e detyrimeve tatimore mbi çmimin e referencës për shitjen e këtyre apartamenteve.

Në përfundim të hetimit gjyqësor, nga aktet e administruara rezulton se nuk verifikohen veprime të kryera në kushtet e konfliktit të interesit, sa kohë u provua se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë në cilësinë e ushtruesit të ndjekjes penale për ndonjë nga subjektet shitës të këtyre dy pasurive të paluajtshme. Në të njëjtën kohë, nëpërmjet akteve të administruara gjatë këtij gjykimi, u provua se pagesa e detyrimeve tatimore mbi çmimin e referencës për shitjen e këtyre apartamenteve nuk ishte kryer nga ana e subjektit të rivlerësimit apo të personave të lidhur me të.

Për sa i takon *kryerjes së veprimeve fiktive*, në lidhje me çmimin e blerjes së këtyre dy apartamenteve, referuar mundësisë financiare për t’i mbuluar me të ardhura të ligjshme pagesat përkatëse, mbetet për t’u vlerësuar fakti se:

(i) referuar kontratës së shitblerjes së datës *.12.2011, pasuria “*Apartament banimi 102 m²*” ka një çmim total prej 7,500,000 lekësh, ndërkohë *çmimi i tregut të lirë*, i cili shërben për llogaritje të tatimit sipas udhëzimit nr. 9/2008², është në vlerën totale prej 17,955,000 lekësh, pra është blerë rreth 60% më lirë;

(ii) referuar kontratës së shitblerjes së datës *.7.2014, pasuria “*Apartament banimi 63 m²*” ka një çmim prej 7.431.660 lekë³, ndërkohë *çmimi i tregut të lirë*, i cili shërben për llogaritje të tatimit sipas udhëzimit nr. 9/2008, është në vlerën totale prej 12.033.000 lekë, pra është blerë rreth 40% më lirë.

Referuar burimit të ligjshëm të të ardhurave të ligjshme, edhe pas hetimit gjyqësor në Kolegj, si dhe administrimit të provave të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, rezulton se ky i fundit mbetet në pamundësi financiare për të mbuluar me të ardhura të ligjshme, të realizuara nga burime të ligjshme, në një shumë prej 2.061.306 ALL, shumë kjo e cila ka shërbyer për krijimin

² Udhëzimi nr. 9, datë 26.2.2008, “Për tatimin e kalimit të së drejtës së pronësisë së paluajtshme”, i ndryshuar.

³ Konvertuar çmimi në kontratë, që është 53.000 euro.

e pasurive të paluajtshme dhe krijimin e likuiditeteve të deklaruara ndër vite, sikurse do të detajohet në vijim.

Në lidhje me vlerën prej 1.400.000 ALL, e cila ka shërbyer si një nga burimet e krijimit të depozitës bankare prej 53.000 euro⁴, në emër të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes së tij, përdorur në vijim si burim për blerjen e apartamentit, me vendndodhje rruga “*** **”, Tiranë, rezulton se provueshmëria e verifikimit të ligjshmërisë së këtyre të ardhurave, në kuptim të nenit D të aneksit të Kushtetutës, mungon.

Përpos parashtrimeve të ankimit dhe atyre të administruara në këtë gjykim, që lidhen me vlefshmërinë juridike të veprimeve të kryera (*kontratë shitje e asetëve e shoqërisë “***” sh.p.k., në likuidim*) nga ana e personit të lidhur me subjektin e rivlerësimit, mbetet e provuar se, për vlerën e të ardhurave të realizuara prej 1.400.000 lekë, nuk janë paguar detyrimet tatimore, në kohën e transaksionit.

Pagesa e detyrimeve tatimore nga ana e personit të lidhur, e kryer në datën *.5.2019, gjatë procesit të rivlerësimit, bazuar në jurisprudencën e Kolegjit, në funksion të shkaqeve të ankimit, nuk plotëson përcaktimet e parashikuara në nenin D, të aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, për t’u konsideruar shuma prej 1.400.000 ALL si e ardhur e ligjshme, krijuar nga një burim i ligjshëm.

Po ashtu, gjendja e të ardhurave, e shpenzimeve dhe likuiditetet e krijuara gjatë viteve 2005 dhe 2011, që kanë shërbyer për krijimin e gjendjes *cash* të përdorur ndër vite, mbetën në të njëjtën situatë provueshmërie, duke munguar kushtet për t’u konsideruar si të mbuluara me të ardhura të ligjshme, respektivisht me diferenca negative në vitin 2005, në vlerën 214.246 ALL dhe 447.060 ALL.

III. Për kontrollin e kriterit të figurës

Sikundër është parashtruar në shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik, vendimi i Komisionit për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit u bazua në raportin e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK), nr.*** prot., datë *.11.2017⁵, mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit z. Petrit Çano, me anë të cilit konstatohet *përshtatshmëria për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit*. Ky raport i grupit të punës, sikurse evidentohet në të njëjtën shkresë *ishte përpiluar pa përgjigjen e një prej 3 institucioneve verifikuese*.

Gjatë hetimit gjyqësor, referuar shkaqeve të ankimit, nisur nga përmbajtja e nenit 39, “Procedura për kontrollin e figurës”, e ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik kërkoi administrimin e raportit mbi kontrollin e figurës, akt i cili duhet të përmbante informacionet e të gjithë autoriteteve informuese, të parashikuara në ligj.

Me shkresën nr. *** prot., datë *.6.2021, DSIK-ja ka dërguar dhe është administruar si provë në këtë gjykim, raporti mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, z. Petrit *** Çano.

⁴ Kjo depozitë bankare ka shërbyer për blerjen e pasurisë “*Apartament banimi*”, rruga “*** **”.

⁵ Deklasifikuar plotësisht me vendimin e KDZH-së nr. ***, datë *.9.2018.

Bazuar në këtë raport, deklasifikuar pjesërisht me vendimin e KDZH-së nr. ***, datë **.6.2021, rezulton se, nisur nga të dhënat e siguruar nga autoritetet verifikuese, është ndryshuar konstatimi fillestar i dhënë për subjektin e rivlerësimit Petrit Çano, nga përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës në papërshtatshmëri për vazhdimin e detyrës, nisur nga informacionet mbi të cilat ngrihen dyshime për përfshirjen e tij në veprimtari të kundërligjshme, kryesisht në atë të shpërdorimit të detyrës.

Ky trup gjykues kreu vetë ai veprime vijuese hetimore, duke u njohur në burim me të dhënat e autoritetit informues, si dhe duke administruar edhe një korrespondencë me autoritetin përkatës për statusin aktual të trajtimit të informacionit që lidhet me subjektin rivlerësues.

Me gjithë përpjekjet procedurale, Komisionerit Publik nuk iu mundësua njohja me të dhënat në burim, ashtu sikurse dhe me detaje në lidhje me subjektet e përfshira në dokumentacionin përkatës, që shërbeu për hartimin e raportit të kontrollit të figurës, për sa kohë shkalla e anonimizimit të përmbajtjes nuk e lejonte.

Në këto kushte, raporti i kontrollit të figurës së DSIK-së, datë **.6.2021, mbetet akti i referuar, për sa përmban si konstatim.

IV. Për kontrollin e kriterit të aftësisë profesionale

Referuar vlerësimit të kriterit të aftësisë profesionale, duke iu qëndruar parashtrimeve të seancës së datës 27.4.2021, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, prej vitit 2000, ushtron funksionet e drejtuesit në organin e Prokurorisë së juridiksionit të përgjithshëm pranë Gjykatave të Shkallës së Parë, Vlorë (2000-2008), Lushnjë (2008-2015) dhe, prej vitit 2015, vijon aktualisht si drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Krujë.

Nga dhjetori i vitit 2015, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Krujë, deri në miratimin e ndryshimeve të K. Pr. P., me ligjin nr. 35/2017, ka qenë në cilësinë e prokurorit epror, me kompetenca kontrolluese ndaj veprimtarisë së prokurorëve më të ulët të asaj Prokurorie, në ushtrimin e detyrës.

Pas ndryshimeve të ndodhura me ligjin nr. 35/2017 në K. Pr. P. dhe miratimin e ligjit nr. 97/2016, subjekti i rivlerësimit, bazuar në dispozitat e Kreut V të ligjit nr. 97/2016, në ndryshim të kompetencave të prokurorit epror, drejtuesit të Prokurorisë i njihen kompetenca në lidhje me: (i) drejtimin e Prokurorisë; (ii) ushtrimin e ndjekjes penale; (iii) nxjerrjen e udhëzimeve të përgjithshme të detyrueshme dhe (iv) nxjerrjen e udhëzimeve jo të detyrueshme për çështje konkrete.

Ndërkohë, në zbatim të dispozitave të K.Pr.P., ligjit nr. 9331/1998, të ndryshuar, ligjit nr. 8328/1998, ligjit nr. 81/2020, subjekti i rivlerësimit është në cilësinë e drejtuesit të zyrës të organit të Prokurorisë, që, përveç kompetencës që i njeh juridiksioni gjyqësor për hetimin e veprave penale të parashikuara nga Kodi Penal, është përgjegjëse dhe për mbrojtjen e interesit publik gjatë fazës së ekzekutimit të dënimeve me burgim, të caktuar nga vendimet penale, të dhëna nga gjykatat shqiptare ose ato të autoriteteve gjyqësore ndërkombëtare, që janë njohur nga

ana e gjykatave shqiptare në zbatim të legjislacionit vendas dhe Konventave ndërkombëtare, të nënshkuara nga ana e Republikës së Shqipërisë.

Sikundër kemi parashtruar, në kompetencën tokësore të Gjykatës së Shkallës së Parë, Krujë (neni 470 i K. Pr. P.), pranë së cilës funksionon zyra e Prokurorisë, që drejton subjekti i rivlerësimit, kanë vendndodhjen dy institucione të ekzekutimit të vendimeve penale, institucioni i veçantë Krujë dhe ai i Fushë-Krujës, ku brenda këtij të fundit funksionojnë regjimi i sigurisë së lartë dhe ai i sigurisë së zakonshme, për efekt të ekzekutimit të vendimeve me burgim.

Nisur nga fakti se ankimi i Komisionerit Publik kundër vendimit nr.183/2019, të Komisionit, është ushtruar për të tria kriteret e rivlerësimit, nga burime të hapura dhe të aksesueshme publike të të dhënave zyrtare, siç është faqja zyrtare e internetit e Këshillit të Lartë të Prokurorisë⁶, Komisioneri Publik, referuar kompetencave ligjore që ushtron subjekti i rivlerësimit, si drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Krujë dhe përmbajtjes së vendimit nr. **, datë **.3.2021 të KLP-së, për shkarkimin nga detyra të një magjistrati/prokurori të Prokurorisë së drejtuar nga subjekti i rivlerësimit, u kërkua hetimi i mëtejshëm për sa i takon përfaqësimit të interesit publik nga ana e Prokurorisë gjatë gjykimit të çështjeve gjyqësore, mbi kërkimin e të dënuarve në fazën e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore penale.

Nisur nga dokumentacioni i marrë nga ana e këtij trupi gjykues për periudhën në lidhje me numrin e kërkesave të gjykuara (për të cilat është dhënë vendim mbi kërkimin e kërkuesit/të dënuarit) gjatë fazës së ekzekutimit të vendimeve penale dhe vendimeve përkatëse me objekt: (i.i) qëndrimi në shtëpi (neni 59/a i K. Penal); (i.ii) lirim para kohe me kusht (neni 64 dhe 65 i K. Penal); (i.iii) llogaritje e paraburgimit; (i.iv) njohje amnistie; të shqyrtuara me prezencë të prokurorit pranë kësaj gjykate, në periudhën 1.1.2016-aktualisht, periudhë gjatë së cilës subjekti i rivlerësimit kryen detyrën e drejtuesit, nga aktet e administruara në cilësinë e provës gjatë hetimit gjyqësor, rezultoi se:

- Për kërkesat e paraqitura me objekt zbatimin e dispozitës “*Qëndrim në shtëpi*”, për periudhën 2016-2020, Gjykata e Shkallës së Parë, Krujë ka disponuar me 16 vendime për pranim kërkesë, nga të cilat është ushtruar ankim vetëm për 1 vendim në vitin 2019;
- Për kërkesat e paraqitura me objekt zbatimin e dispozitës “*Lirim me kusht*”, për periudhën 2016-2020, Gjykata e Shkallës së Parë, Krujë ka disponuar me 43 vendime pranim kërkesë, nga të cilat është ushtruar ankim për 8 vendime⁷;
- Për kërkesat e paraqitura me objekt zbatimin e dispozitës “*Rillogaritje paraburgimi*”, për periudhën 2016-2020, Gjykata e Shkallës së Parë, Krujë ka disponuar me 14 vendime pranim kërkesë, nga të cilat është ushtruar ankim për 1 vendim në vitin 2020;
- Për kërkesat e paraqitura me objekt zbatimin e dispozitës “*Njohje amnistie*”, për periudhën 2016-2020, Gjykata e Shkallës së Parë, Krujë ka disponuar me 18 vendime pranim kërkesë, nga të cilat është ushtruar ankim për 1 vendim në vitin 2016 dhe 1 vendim në vitin 2017.

⁶ https://klp.al/wp-content/uploads/2021/04/Vendimi%20perfundimtar%20***%20***%20per%20publikim.pdf – akt publik referuar nenit 149, të ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar.

⁷Në vitin 2016 për 1 vendim, në vitin 2017 për 2 vendime, në vitin 2018 për 1 vendim, në vitin 2019 për 2 vendime, në vitin 2020 për 2 vendime.

Referuar ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ndër burimet mbi bazën e të cilave vlerësohet drejtuesi i Prokurorisë janë edhe të dhënat statistikore, të cilat, në rastin konkret të pashoqëruara me analizë për secilin rast mosankimi, pa paragjykuar vendimmarrjen për mosankim, janë të një niveli të ulët në raport me pranimet e kërkesave të të dënuarve nga Gjykata.

Po t’i referohemi të dhënave të administruara si provë gjatë këtij gjykimi, rezulton se, nga 14 vendime të marra për pranimin e kërkesës për rillogaritje dënimi, të paraqitur nga të dënuarit, nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Krujë është ankimuar vetëm 1 vendim.

Ndërkohë, KLP-ja, në vendimin e saj nr. **, datë **.3.2021, ka gjetur në shkelje të ligjit 4 vendimmarrje të magjistratit/prokuror pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Krujë për të mos ushtruar ankim ndaj vendimeve për rillogaritje dënimi. Gjatë këtij gjykimi u pretendua se kërkesat me objekt rillogaritje dënimi bazohen në përlllogaritje matematikore.

Porse, rasti i trajtuar në vendimin nr. **, datë **.3.2021, të KLP-së, për kërkesën e paraqitur nga i dënuari për rillogaritje dënimi, është më se i mjaftueshëm për të kuptuar se mosankimi i vendimmarrjeve, edhe në të tilla kërkesa, cenon jo vetëm interpretimin e legjislacionit të brendshëm penal, por dhe atë të konventave ndërkombëtare të nënshkruara nga vendi ynë, mbi bazën e të cilave kryhet transferimi i të dënuarve shqiptarë drejt Shqipërisë, nga autoritetet gjyqësore ndërkombëtare.

Po ashtu, po t’i referohemi të dhënave të administruara si provë gjatë këtij gjykimi, rezulton se nga 18 vendime të marra për pranimin e kërkesës për përfitim amnistie, të paraqitura nga të dënuarit, nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Krujë janë ankimuar vetëm 2 vendime.

Ndërkohë, KLP-ja, në vendimin e saj nr. **, datë **.3.2021, ka gjetur në shkelje të ligjit 7 vendimmarrje të magjistratit/prokuror pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Krujë për të mos ushtruar ankim ndaj vendimeve për përfitim amnistie.

Rastet e trajtuara në vendimin nr. **, datë **.3.2021, të KLP-së, tregojnë se në këto vendime, për pranimin e kërkesave për përfitim nga amnistia, të dënuarit kanë përfituar ulje dënimi, edhe kur veprat penale për të cilat ata ishin duke vuajtur dënimin, ishin të përjashtuara nga ligjvënësi për të përfituar nga amnistia, për shkak të rrezikshmërisë së lartë shoqërore të veprës penale dhe autorëve të saj.

Të tilla vendimmarrje, për pranimin e kërkesave me objekt rillogaritje dënimi apo përfitim nga amnistia, të paankimuara nga ana e organit të Prokurorisë, kanë passjellë paraqitjen nga ana e të dënuarve përfitues të kërkimeve me objekt lirimin para kohe me kusht.

Nga 43 vendime të Gjykatës së Shkallës së Parë, Krujë, për pranimin e kërkesës për lirim para kohe me kusht, janë ankimuar nga Prokuroria, e drejtuar nga subjekti i rivlerësimit, gjithsej 8 vendime.

Referuar sa më lart, konstatohet se me miratimin e ligjit nr. 97/2016, drejtuesi i Prokurorisë, funksion i ushtruar nga subjekti i rivlerësimit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Krujë, ndër të tjera, ka si kompetencë: (i) organizon shpërndarjen e çështjeve prokurorëve⁸; (ii) të mbikëqyrë disiplinën në punë të prokurorëve dhe i bën kërkesë ILD-së për fillimin e inspektimit për shkelje disiplinore të magjistratëve⁹; (iii) kërkon informacion për ecurinë dhe përfundimin e procedimeve dhe, nëse është e nevojshme, udhëzon me shkrim, sipas këtij ligji¹⁰; (iv) nxjerr udhëzime të përgjithshme detyruese¹¹; (v) nxjerr udhëzime jo të detyrueshme për çështje konkrete¹².

Nga aktet e administruara gjatë këtij gjykimi, referuar kompetencave që ka drejtuesi i Prokurorisë, u provua se subjekti i rivlerësimit, nga tërësia e këtyre kompetencave, ka përmbushur vetëm atë të parashikuar nga shkronja “c”, e nenit 42, të ligjit nr. 97/2016, duke dështuar të përmbushë kompetencat e tjera që do të duhet të ushtronte, me qëllim zbatimin dhe kontrollin e ligjshmërisë gjatë ushtrimit të detyrës nga ana e magjistratëve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Krujë.

V. Kërkimi përfundimtar i ankimit

Në përfundim të këtyre bisedimeve përfundimtare, Komisioneri Publik, në referencë të analizës së provave/akteve të administruara në dosje të Komisionit, provave dhe akteve të administruara gjatë hetimit gjyqësor të vendosur nga trupi gjykues, si dhe parashtrimeve dhe akteve/provave të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e provës, gjatë këtij hetimi gjyqësor, vlerëson se, në vlerësimin tërësor të çështjes, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe, mbështetur në parashikimet e nenit F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, nenit 61, pika 5, dhe nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, kërkohet nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr.183, datë 19.7.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Petrit Çano.

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA

⁸ Shkronja “c”, neni 42 i ligjit nr. 97/2016.

⁹ Shkronja “dh”, neni 42, po aty.

¹⁰ Shkronja “b”, neni 43, po aty.

¹¹ Pikat 1, 2, 4, neni 46, po aty.

¹² Shkronja “c”, pika 1, pikat 2, 3, 4 dhe 6, neni 48, po aty.